



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Nr.4506 I REGJ.THEMELTAR
Nr. 3072 I VENDIMIT

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Apelit Tirane, e perbere nga gjyqtaret:

KRYESUES: METUSH SARAÇI
ANETAR: HYSNI DEMIRAJ
ANETAR: GJIN GJONI

asistuar nga sekretarja *Iva Ferataj*, ne seance gjyqesore te dates 11.09.2014,
mori ne shqyrtim çeshtjen civile qe i perket:

PADITËS: Walter Tosto s.p.a, person juridik i së drejtës Italiane, me
seli në Via Colle Marino, 81-65100, Pescara, Itali,
përfaqësuar në gjykim nga av. Adi Brovina

I PADITUR: “MARE-OIL-SHA”, me seli Prezë, Ahmetaq, Tiranë,
përfaqësuar av. Dalip Bushi.

OBJEKTI: Pagesa e detyrimit kontraktor në masën EURO
700,000.00 (*shtatëqind mijë euro*). Shpenzimet ligjore.

BAZA LIGJORE: Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për
shitjen ndërkombëtare të mallrave” ratifikuar nga
Republika e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr.10092, datë:
09.03.2009. Nenet 450, 476, 481, 730-733, 743 të Kodit
Civil të Republikës së Shqipërisë.

Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane, me vendimin civil nr.**3413** date
12.03.2014 ka vendosur:

- Pranimin e padisë.
- Detyrimin e të paditurit shoqëria “MARE-OIL-SHA” sh.a, që ti
paguajë paditësit Walter Tosto s.p.a, detyrimin kontraktor të
papërmbyshur në shumën prej 700,000.00 (*shtatëqind mijë*) Euro.

- Shpenzimet gjyqësore në masën e llogaritur i ngarkohen të paditurit.
- Bashkë me këtë vendim lëshohet edhe urdhri i ekzekutimit.

Kunder vendimit ka paraqitur ankim pala e paditur dhe parashtrohet keto shkaqe;

- Vendimi i gjykates është i pambeshtetur ne prova.
- Mospermbushja per pagesen ka ardhur si rrjedhoje e defekteve te dy serbatoreve te blera nga pala paditese.
- Detyrimi i pretenduar prej 700.000 Euro nuk ehste i sakte, pasi detyrimi është 600.000 Euro.
- Provat e paraqitura nga pala paditese ne gjykim nuk permbushin kriteret ligjore per vlefshmerine e provave shkresore.
- Faturat e paraqitura, per sherbimet e avokatit ehste fotokopje e pa vertetuar te noteri.
- Tarifat e parashikuara nga avokati jane shume here me te larta se tarifat e aplikuarat zakonisht.
- Kerkojme prishjen e vendimit dhe kthimin e ceshtjes per rigjykim.

GJYKATA E APELIT TIRANE

pasi degjoi relatimin e kryesuesit **Metush SARAÇI**,
per palen paditese Walter Tosto s.p.a, av. Adi Brovina
 e cila u shpreh per lenien ne fuqi te vendimit,
per palen e paditur MARE-OIL-SHA, av. Dalip Bushi.
 i cili u shpreh per ndryshimin e vendimit,
 si dhe pasi shqyrtoi çështjen ne teresi,

VEREN

Vendimi Nr.3413, date 12.03.2014 i gjykates rrethit gjyqesor Tirane është i bazuar ne ligj e ne prova e si rrjedhoje duhet te lihet ne fuqi

Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se,

Se paditësi Walter Tosto s.p.a, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi ku kërkon detyrimin e të paditurit t'i paguajë detyrimin kontraktor në masën EURO 700,000.00 (shtatëqind mijë euro), si dhe shpenzimet ligjore.

Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse Walter Tosto s.p.a dhe i padituri MARE-OIL-SHA, kanë zhvilluar biseda tregtare për lidhjen e një kontrate ku fillimisht i padituri i ka kërkuar paditësit dhënien nga ana e këtij të fundit të ofertës për shitjen dhe instalimin e serbatorëve të karburantit. Pala paditëse i ka dërguar të paditurit ofertën e tij dhe ky i fundit (MARE-OIL-SHA) ka pranuar duke i dërguar me faks më 06.01.2010, pranimin e kushteve të kontratës. Në fund të kontratës shënohet edhe nënshkrimi dhe

vula e pranuesit të ofertës që është i padituri MARE-OIL-SHA. Pala paditëse merrte përsipër gjithashtu jo vetëm furnizimin por edhe montimin e mallit (serbatorë karburanti).

Më datë 22.12.2010 është mbajtur procesverbali i dorëzimit të dy serbatorëve nga 1000 mc tek i padituri, në vendin Durrës, Shqipëri. Më datë 11.02.2011 pala e paditur ka konfirmuar realizimin e punimeve sipas pikës 5 të procesverbalit. Palët kanë rënë dakord që me lidhjen e kontratës të paguhen nga blerësi 50.000 euro, ndërsa brenda Gushtit 2010 të paguhen edhe 300.000 Euro të tjera, e më tej shuma e mbetur prej 850.000 euro të paguhet me 17 këste mujore nga 50.000 euro në muaj. Pala paditëse ka lëshuar edhe faturën nr.374, datë: 30.11.2010 në lidhje me shumën preej 850.000 euro që mbetej për tu shlyer.

Gjatë gjykimit rezultoi po ashtu se pala e paditur ka bërë pagesa të pjesshme të detyrimit të saj kontraktor dhe se më pas ka ndërprerë kryerjen e tyre. Kjo ka detyruar paditësin që të dërgojë njoftime të njëpasnjëshme drejt të paditurit në lidhje me pagimin prej këtij të fundit të detyrimeve sipas kësteve mujore. Kësti i parë mujor që filloi të mos paguhej ishte ai i Shkurtit 2011. Në shkresën e datës 28.06.2012 pala paditëse njofton palën e paditur se duhet t'i paguajë 700.000 euro si detyrim kontraktor të papaguar. Më 31 Korrik 2012 i padituri i kthen përgjigje palës paditëse se nuk ka mundur të bëjë pagesat për shkak se personeli bankar është me pushime, e për këtë shkak nevojitej me shumë kohë. Po ashtu më datë 15 Shtator të atij viti, i padituri propozonte të takoheshin për të diskutuar për mosmarrëveshjen midis tyre. Mbasi ka kaluar edhe pothuajse një vit nga ky komunikim dhe pala e paditur nuk ka paguar detyrimin monetar që i kishte paditësit, ky i fundit është detyruar të paraqesë padi në gjykatë më datë 17.06.2013, sipas objektit të mësipërm. Gjatë gjykimit pala paditëse pakësoi objektin sa i përket kërimit të interesave të shumës së papaguar dhe kërkoi që të paguhej vetëm detyrimi si dhe shpenzimet gjyqësore.

Në lidhje me sa më sipër në nenin 698 të Kodit Civil parashikohet se në kontratat me detyrime të ndërsjellta (*siç është kontrata që përbën faktin krijues të detyrimit në këtë gjykim*), kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të dëmit. Gjykata në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje mban parasysh edhe parashikimin e nenit 476 të Kodit Civil si dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave” aderuar nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr.10092, datë: 09.03.2009, ku në nenin 11 të kësaj Konvente përcaktohet se:

“Një kontratë shitje nuk ka nevojë që të lidhet ose provohet me shkrim dhe nuk i nënshtrohet ndonjë kërkesë tjetër në lidhje me formën. Ajo mund të provohet me çdo mjet, duke përfshirë dëshmitarë.”

Neni 14 i Konventës parashikon edhe se:

“1. Një propozim për lidhjen e një kontrate, drejtuar një apo më shumë personave specifike përbën një ofertë, në qoftë se ai është mjaft i qartë dhe tregon qëllimin e ofruesit për ta lidhur në rast pranimi. Një propozim është mjaft i qartë nëse tregon mallrat dhe shprehimisht ose tërthorazi cakton ose parashikon kushtet për përcaktimin e sasisë dhe çmimit.

2. Një propozim, tjetër nga ai i drejtuar tek një ose më shumë persona specifike duhet të konsiderohet thjesht si ftesë për të bërë ofertën, përveç kur e kundërta tregohet qartë nga personi që bën propozimin.”

Nga provat e paraqitura prej palëve rezulton se i padituri ka dërguar ftesë për ofertë e më pas paditësi ka dërguar ofertën specifike, të cilën e ka pranuar i padituri. Pra, dinamika e bisedimeve tregtare midis palëve u provua gjatë gjykimit.

Sa i përket prapësimit të të paditurit në lidhje me zbatimin e nenit 36 të Konventës (përveç çështjeve të provueshmërisë), duhet theksuar se në nenin 39 të kësaj Konvente përcaktohet se:

“1. Blerësi humb të drejtën për t'u bazuar në mospërputhjen e mallrave, në qoftë se nuk njofton shitësin duke specifikuar natyrën e mospërputhjes brenda një kohe të arsyeshme pasi e ka zbuluar atë ose duhet ta ketë zbuluar atë.

2. Në çdo rast, blerësi humb të drejtën për t'u bazuar në mospërputhjen e mallrave në qoftë se nuk njofton shitësin për këtë, të paktën brenda një periudhe 2-vjeçare nga data në të cilën mallrat iu dorëzuan në të vërtetë blerësit, përveç kur ky afat kohor nuk përputhet me periudhën e garancisë së kontraktuar.”

Sipas nenit 53 të Konventës:

“Blerësi duhet të paguajë çmimin e mallrave dhe t'i marrë ato në dorëzim siç kërkohet nga kontrata dhe kjo Konventë.”

Më tej neni 59 i Konventës së cituar më sipër, përcakton edhe se:

“Blerësi mund të paguajë çmimin në datën e përcaktuar ose të përcaktueshme nga kontrata dhe kjo Konventë pa pasur nevojë për ndonjë kërkesë ose plotësim të ndonjë formaliteti nga ana e shitësit.”

Gjykata vëren se pala paditëse Walter Tosto S.p.A arriti të provonte faktin krijues (kontratën dhe faturën e palikujduar), konform barrës së provës që kishte sipas nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile. Për faktet eventuale shuese apo ndryshuese, barra e provës i përkiste të paditurit i cili nuk paraqiti asnjë provë në këtë drejtim. Pala e paditur pretendoi se sendi ishte me defekt, por nuk e provoi këtë fakt, që do e justifikonte atë të mos shlyente detyrimin ndaj palës paditëse. Ndaj ky pretendim nuk merret parasysh nga gjykata.

Nga ana tjetër, pretendimi i palës së paditur se provat e paraqitura nga pala paditëse janë jo të rregullta, nuk qëndron. Kjo pasi, rezulton se korrespondenca midis palëve ka qenë në gjuhën Italiane dhe në këtë gjuhë

janë hartuar edhe dokumentet midis palëve. Komunikimi midis tyre ka qenë elektronik. Në këto kushte provat shkresore të paraqitura nga pala paditëse gëzojnë plotësisht vlerën e shkresave private (të thjeshta) dhe kanë fuqinë e rregullt provuese të një shkrese private. Pala paditëse kishte detyrimin që vetëm t'i përkthente ato, çka edhe e ka bërë. Në këtë rast nuk ka vend për legalizim të dokumenteve, pasi ato nuk janë dokumente zyrtare, apo të vërtetuara nga ndonjë organ publik, por komunikime private midis privatëve. Ndaj mënyra e paraqitjes së provave nga pala paditëse vlerësohet e rregullt nga gjykata. Këtu gjykata mban parasysh edhe parashikimin e nenit 1 të Konventës për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaja (1961), aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9060, datë: 08.05.2003. Po ashtu nuk gjen zbatim në këtë rast as VKM nr.134, datë: 7.3.2003 “Për Vërtetimin dhe Legalizimin e Dokumenteve të Lëshuara në Republikën e Shqipërisë për Përdorim Jashtë Vendi dhe të Dokumenteve të Huaja për Përdorim Brenda Vendi” (i ndryshuar).

Pra, sa më sipër, pala paditëse vërtetoi gjatë gjykimit marrëdhënien kontraktore midis palëve ndërgjyqëse, si dhe mospagimin nga i padituri të detyrimit kontraktor në masën 700.000 Euro, ndërsa i padituri nuk paraqiti asnjë provë që të hedhë poshtë pretendimet e palës paditëse, konform barrës së provës që kishte. Në këto kushte ka vend për pranimin e padisë dhe i padituri në këtë rast detyrohet të paguajë jo vetëm shumën e detyrimit, por edhe shpenzimet gjyqësore që përbëhen nga taksa gjyqësore dhe shpërblimi i avokatit, ku për palën paditëse vlera e shërbimeve të avokatisë dhe përfaqësimit kapin vlerën 632.873 lekë, sipas faturës tatimore të lëshuar nga Studio Ligjore “Haxhia & Hajdari” me NIPT K81317053M. Fatura tatimore në këtë rast përfaqëson marrëveshjen midis palëve për shpërblimin e avokatit.

Në përfundim gjykata çmon se padia e paditësit Walter Tosto s.p.a rezulton të jetë e mbështetur në ligj dhe në prova e për këtë arsye duhet pranuar.

Kete vendim e ka ankuar pala e paditur dhe kërkon prishjen e vendimit dhe kthimin e ceshtjes per rigjykim .

Kolegji civil konstaton se vendimi i gjykates te shkalles se pare eshte marre ne perputhje me kerkesat ligjore dhe provat e administruara ne dosjen gjyqesore.

Pala e paditur megjithese e ka kontestuar vleren e detyrimit, duke pretenduar se kestet e papaguara jane ne shumen 600 mije Euro, ne gjykim nuk ka paraqitur asnje prove qe te vertetoje faktin e pagimit te detyrimit kontraktor ne shumen e pretenduar nga pala paditese, objekt i ketij gjykimi. Nga provat e administruara ne dosjen gjyqesore eshte vertetuar se detyrimi kontraktor i pales se paditur eshte ne vleren 700 mije Euro. Prandaj me te drejte gjykata e faktit ka pranuar padine duke detyruar palen e paditur te

paguaje detyrimin kontraktor te permbushur. Gjykata ne zgjidhjen e ceshtjes ka mbajtur parasysh kerkesat ligjore e pikerisht;

Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave” ratifikuar nga Republika e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr.10092, datë: 09.03.2009. Nenet 450, 476, 481, 730-733, 743 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

I pabazuar eshte dhe pretendimi tjetër i pales se paditur lidhur me detyrimet per shpenzimet gjyqesore, per te cilin ka paraqitur ankim te vecante duke kerkuar ndryshimin e vendimit ne pjesen qe ka caktuar shpenzimet gjyqesore te perfaqesimit me avokat. Ky detyrim eshte percaktuar ne perputhje me dispozitat ligjore e pikerisht nenet 102 e vijues te K.Pr.Civile.

Ne caktimin e shpenzimeve lidhur me avokatin e pales paditese eshte mbajtur parasysh fatura tatimore perkatese (faqe 222 e dosjes)

PER KETO ARSYE

Kolegji Civil i gjykates se apelit Tirane, bazuar ne nenin **466/a** te **K.Pr.Civile**,

VENDOSI

Lenien ne fuqi te vendimit Nr.**3413**, date **12.03.2014** te Gjykates se Rrethit Gjyqesor **Tirane**.

Rrezimin persa i perket demshperblimit me 2(dy) paga mujore, per procedure.

Tirane me.11.09.2014

ANETAR

ANETAR

KRYESUES

GJIN GJONI
dv.

HYSNI DEMIRAJ
dv.

METUSH SARAÇI
dv.

Vertetohet njesia me Originalin

KANCELAR

Arber KUSHE